

	Specifikimet teknike
	Specifikime teknike
Karrige rrotulluese me krah mbeshtetes	Karriget të kenë shpinore të regjistrueshme me mekanizëm ulje-ngritje me piston. Karrigia do të mbështetet mbi një bazament në formë ylli të kromuar me 5 rrota në ekstremet e tyre, ku ylli duhet të ketë një diameter jo më të vogël se 60 cm. Rrotat duhet të jenë me material plastik me rezistencë të lartë kundër gërvishtjeve dhe goditjeve si dhe ngarkesë -mbajtëse. Krahët mbështetës të karrigeve të jenë plastike dhe ngarkesëmbajtëse. Shpinorja dhe ndenjësja të kenë mbushje sintetike dhe me densitet të lartë. Tapiceria të jetë në stof të cilësisë së parë. Në pjesën e poshtme montohet një pjastër metalike e cila shërben si mekanizëm për ulje-ngritjen e karriges. Në pjesën e poshtme të shpinores montohet një mekanizëm në formë berryli i cili bën lidhjen e shpinës me ulësen dhe ka funksion ulje-ngritje të shpinës si dhe gradimin në pozicione të ndryshme të saj. E gjithë karrigia montohet me bullona me diameter 6 mm. Ngjyrat janë të ndryshme dhe përcaktimi bëhet në kushtet e lidhjes së kontratës. Përmasat kryesore janë: Ulësja 46 x 48cm, Shpinorja 42 x 50cm, Pistoni në gjendje fillestare jo me pak se 20 dhe hapje maksimale 40cm. Lartesia totale 90 -107cm, thellësia jo më e vogël se 44 cm, gjerësia jo më vogël se 58 cm.
Tavolinë	Suprina me material MDF 30mm trashesi, bordet e harkuara do të frezohen me R =10mm për të eliminuar rrezikun e demtimit gjatë përdorimit. Në pjesën e sipërme të suprinës dhe do të jetë e lyer me boje rezistente ndaj gërvishtjeve. Ngjyra e suprinave do të jetë e ndryshme. Suprina do të mbështetet mbi 4 kembe metalike alumini me seksion rrethor ϕ 50mm dhe me spesor jo më të vogël se 1.5mm. Lartesia e kembeve 720mm. Në pjesën e sipërme këmba do të bashkohet me suprinën me aksesoren bashkues prej alumini nepermjet vidave të drurit (4 x20) . Në pjesën e poshtme do të ketë një mekanizëm për rregullimin e lartësisë dhe në fund me plastike. Përmasat e tavolines dhe mënyra e vendosjes së kembeve jepen në skicën përkatëse.